



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKIA MALLAKASTER
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 1236 Prot.

Ballsh, më 13.03.2023

Lënda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Mallakastër

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë

Për djepi: Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit
Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Mallakastër

I nderuar Kryetar,

Komisioni i Përbërshëm i Financës dhe Ekonomisë shqyrtoi rezultatet e sondazhit të organizuar nga Këshilli Bashkiak mbi prioritetet e komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026. Me anë të kësaj shkrese kërkojmë të reflektoni kërkesat e qytetarëve që dalin nga analiza e sondazhit (bashkëlidhur kësaj shkrese), në tavanet buxhetore të 2024 si pjesë e Projekt Buxhetit 2024-2026, brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Komisioni pret konsiderimin Tuaj të prioriteteve të komunitetit të materializuara dhe relatuesat në tavanet e programit buxhetor afat-mesëm 2024-2026.

KRYETAR

FITIM BARAJ





KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER

ANALIZA E SONDAZHIT NË LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT PËR PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM 2024-2026

QËLLIMI DHE MBARËVAJTJA E SONDAZHIT

Ky sondazh ka për qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrën sesi Bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2022, si dhe të ndihmojë Këshillin Bashkiak të informohet se cilat janë prioritet kryesorë të komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026. Sondazhi merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore si dhe në lidhje me gadishmërinë për të paguar më shumë taksa ose tarifa për të përmirësuar shërbimet që sigurohen nga Bashkia.

Bazuar në rezultatet e këtij sondazhi Këshilli Bashkiak Mallakastër ka përgatitur një shkresë përcjellëse në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzimet buxhetore, e cila synon të ndihmojë administratën e Bashkisë për përcaktimin e taveve përgatitore për 2024-2026.

Pyetjet e sondazhit bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022 dhe shpenzimet për shërbimet kryesore gjatë vitit 2023.

Pyetësi është shpallur në facebook të Këshillit Bashkiak Mallakastër në datë 2 Shkurt 2023 dhe ka qëndruar online deri në datë 28 Shkurt 2023.

REZULTATET E SONDAZHIT

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

275 persona kanë plotësuar pyetësin nga njësi administrative të ndryshme, ndër të cilët 164 femra dhe 93 meshkuj. Nga 257 persona që kanë plotësuar pyetësin, 117 kanë ndarë kontaktet e tyre, kryesisht e-mail. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në sondazh, përkatësisht 161 pjesëmarrës, janë nga Ballshi, 36 pjesëmarrës janë nga njësia administrative Qendër Dukas, 8 pjesëmarrës nga njësia administrative Greshicë, 14 pjesëmarrës nga njësia administrative Aranitas, 11 pjesëmarrës nga njësia administrative Hekal, 10 pjesëmarrës nga njësia administrative Ngracan, 7 pjesëmarrës nga njësia administrative Kutë, 7 pjesëmarrës nga njësia administrative Fratar, 3 pjesëmarrës nga njësia administrative Selitë. Bashkia Mallakastër Memaliaj është e përfaqësuar nga anëtarë të komunitetit që kanë marr pjesë në plotësimin e këtij pyetësi. Për më tepër mund t'i referohemi të dhënave në figurat më poshtë:

Fig nr. 1 Gjinia





Fig nr. 2 Vendbanimi (Rezidenca)






KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER


- Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, përkatësisht 55% (146 persona) i përkasin grupmoshës 31-45 vjeç, 16% (40 persona) grupmoshës 46-60 vjeç, dhe 29% (75 persona) i përkasin moshës 18-30 vjeç. Për më tepër mund t'i referohemi të dhënave në figurën më poshtë:

Fig nr. 3 Grupmosha



- Pjesëmarrësit vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. 78 persona janë të punësuar në sektorin privat, 89 persona janë të punësuar në sektorin publik, 18 persona janë të vetpunësuar, 34 persona kanë zgjedhur opsionin tjetër, 16 persona janë student, 20 persona janë të papunë, dhe 2 persona janë punonjës OJF/akademikë.

Fig nr. 4 Lloji i punësimit



- Nga 275 pjesëmarrës në këtë pyetësor, 12 prej tyre i përkasin shtresave në nevojë, përkatësisht 5 persona (42%) marrin ndihmë ekonomike, ndërsa 7 persona (58%) janë persona me aftësi të kufizuara.

Fig nr. 5 Mbështetja sociale






KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER

OPINIONI NE LIDHJE ME SHPENZIMET BUXHETORE PER SHERBIMET KRYESORE


- Sikurse vihet re nga grafiku në figurën nr. 6, numri i pjesëmarrësve pjesëmarrësve në pyetësor që shprehin dakordësi për mënyrën se si janë kryer disa nga shpenzimet e Bashkisë Mallakastër është i lartë.

Fig nr. 6 Opinioni i qytetarëve për shpenzimet buxhetore për shërbimet kryesore




Qytetarët janë dakort për:

- Shpenzimet e kryera për planifikim, administrim dhe menaxhim (90.7% e qytetarëve që kanë marr pjesë në këtë pyetësor janë dakort, 6.2% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më shumë në investime, 2,7% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më pak, dhe 0.4% kanë zgjedhur opsionin nuk e di)




- Shpenzimet e kryera për rrugë rurale (87.5% e qytetarëve që kanë marr pjesë në këtë pyetësor janë dakort, 10.1% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më shumë, 1.6% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më pak, dhe 0.8% kanë zgjedhur opsionin nuk e di)






KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER


- Shpenzimet e kryera për arsimin parashkollor (71.6% e qytetarëve që kanë marr pjesë në këtë pyetësor janë dakort, 26.5% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më shumë, 0% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më pak, dhe 1.9% kanë zgjedhur opsionin nuk e di)



- Shpenzimet e kryera për menaxhimin e mbetjeve (63.8% e qytetarëve që kanë marr pjesë në këtë pyetësor janë dakort, 34.2% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më shumë, 0.8% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më pak, dhe 1.2% kanë zgjedhur opsionin nuk e di)



- Shpenzimet e kryera për pastrim dhe gjelbërim (84% e qytetarëve që kanë marr pjesë në këtë pyetësor janë dakort, 9.3% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më shumë, 5.4% e qytetarëve mendojnë se duhen shpenzuar më pak, dhe 1.2% kanë zgjedhur opsionin nuk e di)






KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER


PERCEPTIMI QYTETAR PER PUNEN E BASHKISE

- Referuar grafikut në figurën nr. 7, vërehet dakordësi e pjesëmarrësve për performancën e Bashkisë. Pjesa më madhe e qytetarëve vlerësojnë pozitivisht punën e bashkisë për shumicën e shërbimeve të ofruara.

Fig nr. 7 Vlerësimi i qytetarëve për kryerjen e shërbimeve bashkiake



- Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (61.9% e pjesëmarrësve e vlerësojnë shumë mirë, 35.4% e vlerësojnë mirë, 2.7% e vlerësojnë jo mirë, 0.0% nuk e di)



- Rrugë rurale (58.8% e pjesëmarrësve e vlerësojnë shumë mirë, 37% e vlerësojnë mirë, 4.3% e vlerësojnë jo mirë)




- Arsimi parashkollor (50.6% e pjesëmarrësve e vlerësojnë shumë mirë, 45.1% e vlerësojnë mirë, 4.3% e vlerësojnë jo mirë, 0% nuk e di)





KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER

- Menaxhimi i mbetjeve (50.6% e pjesëmarrësve e vlerësojnë shumë mirë, 43.6% e vlerësojnë mirë, 5.8% e vlerësojnë jo mirë, 0% nuk e di)




- Pastrim, gjelbërim (49.4% e pjesëmarrësve e vlerësojnë shumë mirë, 44% e vlerësojnë mirë, 5.8% e vlerësojnë jo mirë, 0.8% nuk e di)



PRIORITETET E KOMUNITETIT NE LIDHJE ME BUXHETIN 2024

➤ Sipas tabelës në figurën nr. 8 prioritetet e qytetarëve janë si më poshtë:

Marrëdhëniet me komunitetin	112
Shërbimet e tregjeve dhe inspek...	58
Shërbimet bujqësore	68
Pyjjet dhe kullotat	26
Transporti publik	26
Programe zhvillimore	136
Turizmi	27
Planifikimi urban vendor	130
Ndricim rrugësh	172
Kujdesi parësor shëndetësor	80
Trashëgimia kulturore	27
Arsimi profesional	61
Kujdesi social për personat e së...	88
Papunësia	55
Strehimi	36
Menaxhimi i infrastrukturës së u...	68
Menaxhimi i ujërave të zeza	40



- Shërbimet të cilat konsiderohen si prioritet nga qytetarët që kanë marr pjesë në këtë pyetësor, konsistojnë në:
 - 1- Ndricim rrugësh – 172 persona
 - 2- Programe zhvillimore – 136 persona
 - 3- Planifikim urban vendor - 130 persona
 - 4- Marrëdhëniet me komunitetin – 112 persona
 - 5- Kujdesi social për personat e sëmurë – 88 persona
 - 6- Kujdesi parësor shëndetësor – 80 persona
 - 7- Arsimi profesional – 61 persona
 - 8- Menaxhimi i infrastrukturës së ujitje, kullim – 68 persona



KESHILLI BASHKIAK MALLAKASTER

GADISHMERIA PER TE PAGUAR ME SHUME TAKSA PER SHERBIMET KRYESORE

➤ Përqindja më e madhe e pjesëmarrësve në sondazh nuk janë dakort të paguajnë më shumë taksa për shërbime më cilësore. Shërbimet për të cilat qytetarët janë më të predispozuar për të paguar më tepër taksa, janë për:

- Rugët rurale
- Arsimin parashkollor
- Menaxhimin e mbetjeve




Fig nr. 9 Gadishmëria e qytetarëve për të paguar më shumë taksa ose tarifa për shërbimet kryesore

➤ Vlerësimi i performancës së bashkisë nga 1 në 5

4.15
Valutazione media




Fig nr. 10 Vlerësimi i performancës së bashkisë nga qytetarët